



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA005

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 28 maj 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me  
sqarimin e afateve**

---

**Gjykatësve të panelit të Gjykatës së Apelit**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së viktimave:**

Ani Pues

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagendra

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në përputhje me nenet 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 113(6) dhe 169 të Rregullores së Procedurave dhe Provave para Dhomave të Specializuara (“DSK”) dhe rregullën 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin”), me anë të këtij vendimi cakton panelin e Gjykatës së Apelit për sqarimin dhe ndryshimin e afateve sipas rregullës 9(5) të Rregullores”, dorëzuar më 28 maj 2021 (“Mocioni”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë për pjesëmarrjen e viktimave.<sup>2</sup>
2. Më 28 maj 2021, mbrojtësja kujdestare e caktuar për të ndihmuar me apelin personat të cilëve u është refuzuar kërkesa, dorëzoi mocionin ku kërkonte një sqarim lidhur me afatet dhe “në rast se afati është të hënën, 31 maj 2021, a mund të shtyhej me një javë për në 7 qershor 2021[...]”.<sup>3</sup>

## II. NJOFTIM PËR CAKTIMIN

3. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin, përfshirë përvojën dhe ekspertizën përkatëse si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### **KRYETARJA CAKTON:**

---

<sup>1</sup> IA005-F00001.

<sup>2</sup> F00257/RED.

<sup>3</sup> IA005-F00001, para. 17.

**Gjykatëse Mishelë Pikar**

**Gjykatës Emilio Gati**

**Gjykatës Kai Ambos**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me kërkesën.

**/nënshkrimi/**

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premtë më 28 maj 2021

Në Hagë,

Holandë